



Pranuar / Dorezuar Priljepe/Pridato Received/Delivered	05-07-2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinita Org./Unit	Nr Prot Pr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSHICK	3931/2022		115



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.520/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita-Haxhnikaj-Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca, anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.2193/2020 të datës 25.05.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka rishqyrtuar ankesën me numër A.nr.270/2020 të datës 15.09.2020 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi kundër organit të punësimit Agjencia e Statistikave të Kosovës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datës 05.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Apropohet si e bazuar ankesa 270/2020 të datës 15.09.2020 e parashtruar nga ankuesja
- II. Obligohet Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të inicioj veprimet e nevojshme ligjore për harmonizimin të koeficientit të pagës së nëpunëses civile nga koeficienti shtatë (7) në tetë (8), si dhe të bëj kompensimin e diferencës së koeficientit të pagës në mënyrë retroaktive duke filluar nga data 28.08.2020 deri në zbatimin e këtij vendimi.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesja nëpunëse civile në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, me datë 15.09.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës Për Shërbimin Civil, për

shkak të mos zbatimit të Njoftimit të datës 28.08.2020 të Ministrisë së Punëve të Brendshme për harmonizim të koeficientit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin A.nr.270/2020 të datës 10.11.2020 ka refuzuar ankesën e ankueses si të pabazuar. Me tej ankuesja ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa kjo e fundit me Aktgjykimin A.nr.2193/2020 të datës 25.05.2022 ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, duke anuluar vendimin e Këshillit dhe të njëjtin e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje të Këshilli.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për vendosje meritore lidhur me çështjen ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.270/2020 e parashtruar më datë 15.09.2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 21.09.2020; Akt Emërimit e datës 28.03.2012; Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit; Përshkrimin e Detyrave të Punës i datës 06.01.2016; e-mail nga ariana@opendatakosovo.org për B.L. etj i datës 26.03.2021; e-mail nga Rr.Z. për D.S. i datës 28.08.2020; e-mail nga V.J. për SH.M. i datës 01.03.2016; e-mail nga SH.M. për V.J. i datës 29.01.2016; e-mail nga V.J. për SH.M. i datës 16.02.2016; e-mail nga SH.M. për V.J. i datës 29.01.2016; e-mail nga SH.M. për V.J. i datës 29.01.2016; e-mail nga I.K. për A.B. etj. i datës 02.02.2016; e-mail nga V.J. për I.K. i datës 02.02.2016; e-mail nga V.J. për SH.M. i datës 16.02.2016; e-mail nga SH.M. për V.J. i datës 29.01.2016; e-mail nga V.J. për SH.M. i datës 01.03.2016; e-mail nga SH.M. për V.J. i datës 29.01.2016; e-mail nga V.J. për D.S. i datës 01.03.2016; e-mail nga D.S. për T.M. i datës 27.08.2020; e-mail nga D.S. për T.M. i datës 24.07.2020; e-mail nga Rr.Z. për D.S. i datës 28.08.2020; e-mail nga D.S. për SH.M. i datës 03.09.2020; e-mail nga D.S. për SH.M. i datës 03.09.2020; e-mail nga Rr.Z. për D.S. i datës 28.08.2020; e-mail nga SH.M. për D.S. i datës 03.09.2020; e-mail nga D.S. për SH.M. i datës 03.09.2020; e-mail nga D.S. për N.SH. i datës 07.09.2020; e-mail nga SH.M. për D.S. i datës 03.09.2020; e-mail nga D.S. për SH.M. i datës 03.09.2020; e-mail nga Rr.Z. për D.S. i datës 28.08.2020; e-mail nga D.S. për N.SH. i datës 09.09.2020; e-mail nga D.S. për N.SH. i datës 07.09.2020; e-mail nga SH.M. për D.S. i datës 03.09.2020; e-mail nga D.S. për SH.M. i datës 03.09.2020; e-mail nga Rr.Z. për D.S. i datës 28.08.2020; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 31.12.2018; Formularët vlerësimi i detyrave i datës 14.01.2019; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 31.12.2019; Formularët vlerësimi i detyrave i datës 03.01.2020; Organogrami i ASK-së; Përgjigjen në ankesë e datës 02.10.2020; e-mail nga Rr.Z. për D.S. i datës 28.08.2020; e-mail nga SH.M. për V.J. i datës 29.01.2016; e-mail nga I.K. për A.B. etj. i datës 02.02.2016; e-mail nga V.J. për I.K. i datës 02.02.2016; e-mail nga V.J. për SH.M. i datës 16.02.2016; e-mail nga SH.M. për V.J. i datës 29.01.2016; e-mail nga V.J. për SH.M. i datës 01.03.2016; e-mail nga SH.M. për V.J. i datës 29.01.2016; e-mail nga V.J. për D.S. i datës 01.03.2016; e-mail nga D.S. për V.J. i datës 29.02.2016; e-mail nga Rr.Z. për D.S. i datës 28.08.2020; e-mail nga SH.M. për V.J. i datës 29.01.2016; e-mail nga I.K. për A.B. etj. i datës 02.02.2016; e-mail nga V.J. për I.K. i datës 02.02.2016; e-mail nga V.J. për SH.M. i datës 16.02.2016; e-mail nga SH.M. për V.J. i datës 29.01.2016; e-mail nga V.J. për SH.M. i datës 01.03.2016; e-mail nga SH.M. për V.J. i datës 29.01.2016; e-mail nga V.J. për D.S. i datës 01.03.2016; e-mail nga D.S. për V.J. i datës 29.02.2016; Vendim i datës 29.10.2020; Kërkesën për shtyrje të afatit për vendosjen e ankesës i datës 29.10.2020; Shkresën e Komisionit për klasifikim të vendeve të punës 15.07.2016 si dhe lista e klasifikimit; Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative A.nr.2193/2020 i protokolluar me numër 3284/2022 më datë 06.06.2022 në KPMSHCK; Procesverbalin e Gjykatës Themelore në Prishtinë

Departamenti për Çështje Administrative i datës 25.05.2022; Autorizimin e datës 25.05.2022; Thirrjen për shqyrtim kryesor i datës 25.05.2022; Fletëkthesën e datës 17.11.2021; Përgjigjen në padi e datës 16.11.2021; Aktvendimin A.nr.2193/20 të datës 14.10.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Fletëkthesën e datës 23.11.2020; Fletëkthesën e datës 19.11.2020; Fletëkthesë e datës 19.11.2020; Fletëkthesë e datës 05.11.2020; Fletëkthesën e datës 03.11.2020; Vendimin A.nr.270/2020 me numër protokollit 2564/2020 i datës 12.11.2020 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Deklaratën për seancë sipas padisë e ankueses e datës 24.05.2022; Kërkesën për avancim nga një kategori (pozitë) më e ulët funksionale në një kategori (pozitë) më të lartë e datës 17.03.2015; Formularin i shpenzimit të departamentit, divizionit ose sektorit ¼ faqe; Kërkesën për rritjen e koeficientit prej 7 në 8 i datës 18.05.2009; Kërkesë për procedimin e autorizimit në DASHC/MAP për rekrutimin e pozitave të lira në ASK i datës 18.10.2017; Vendim me numër 04-052-921 i datës 02.12.2021; Vendim me numër 04-052-653 i datës 24.07.2018; Vendim me numër 04-052-40 i datës 01.02.2022; Vendim me numër 04-052-1734 i datës 19.07.2019; Vendim me numër 04-052-584 i datës 05.07.2018; Vendim me numër 04-052-471 i datës 04.04.2019; Vendim me numër 04-052-53 i datës 25.01.2018; Vendim për organizimin dhe funksionimin e strukturave institucionale për të dhëna të hapura me numër 05/84 i datës 15.01.2019; e-mail nga ariana@opendatakosovo.org për B.L. etj i datës 26.03.2021; Organogrami i ASK-së; e-mail nga Rr.Z. për D.S. i datës 28.08.2020; e-mail nga V.J. për SH.M. i datës 01.03.2016; e-mail nga SH.M. për V.J. i datës 29.01.2016; e-mail nga V.J. për SH.M. i datës 16.02.2016; e-mail nga SH.M. për V.J. i datës 29.01.2016;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në Aktgjykimin A.nr.2193/2020 të datës 25.05.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, dhe pas rishqyrtimit me kujdes të provave të lëndës një nga një dhe të gjitha së bashku konstatoi së është e bazuar ankesa e ankueses, SEPSE:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesja sipas Akt Emërimit me numër protokollit 04-112-212 të datës 02.04.2012, është e emëruar në pozitën e punës *Zyrtare e Lartë*, në Sektorin e Shpërndarjes/Destinimit në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, me koeficient të pagës shtatë (7).

Me tej nga shkresat e lëndës Kolegji i Këshillit ka gjetur së pozita e punës *Zyrtar i Destinimit*, nuk ka qenë e përfshirë në Katalogun e Vendeve të punës në Shërbim Civil i miratuar sipas Vendimit të Qeverisë së Kosovës Nr.05/12 të datës 05.02.2015, dhe për këtë arsye organi i punësimit/njësia e personelit disa herë radhazi ka kërkuar nga DASHC-ja si njësi përgjegjëse për shqyrtimin dhe vlerësimin e pozitave dhe koeficienteve të pagës së shërbyesve civil, që pozita *Zyrtar i Destinimit*, të përfshihet në katalogun e vendeve të punës në Shërbim Civil. Ndërsa DASHC fillimisht me emailin e datës 02 shkurt 2016 ka vlerësuar se pozita *Zyrtare e Lartë e Destinimit* duhet të jetë *Zyrtar Administrativ AD/450*, pastaj me datë 16.02.2016 ka konfirmuar së pozita e ankueses është vendosur me titull "*Zyrtar për Statistika*" ST/410, ndërsa me e-mailin e datës 01.03.2016 DASHC-ja ka ndryshuar titullin e pozitës në fjalë, duke vendosur që kjo pozitë të emërtohet *Zyrtar i Lartë për Statistika* me Kod ST/500 dhe koeficient tetë (8) të pagës.

Po nga vlerësimi i shkresave të lëndës rrjedhë së bazuar në kërkesën e DASHC-së, Agjencia e Statistikave të Kosovës ka themeluar Komisionin për klasifikimin e vendeve të punës, ku me datë 15.07.2016 ky Komision ka përcjell në DASHC Raportin e klasifikimit të vendeve të punës në Agjencinë e Statistikave të Kosovës dhe se me asnjë shkresë nuk vërtetohet se raporti në fjalë të jetë

aprovuar nga organet gjegjëse respektivisht nga Ministria e Financave dhe Ministria e Administratës Publike, rrjedhimisht sipas këtij raporti ankuesja është propozuar që të ketë emërtimin e punës "Udhëheqëses se Divizionit për Kualitet të Kontrollit" me kod BF/1020 gradë shtatë (7) të pagës.

Për shkak të mos harmonizimit të koeficientit të pagës, ankuesja me datë 24.07.2020, i është drejtuar me kërkesë në DASHC-së për harmonizimin e koeficientit të pagës nga koeficienti shtatë (7) në koeficientin tetë (8) pasi që pozita e saj është emërtuar dhe konfirmuar nga DASHC "Zyrtare e Lartë për Statistika" me Kod ST/500, koeficient tetë (8) të pagës, kurse në përgjigje të kërkesës së ankueses, Udhëheqësi i Divizionit për Politika të Pagave në Departamentin për Administrimin e Shërbimit Civil më datë 28.08.2020 ka njoftuar ankuesen se duke u aplikuar kriteret për klasifikimi e vendeve të punës, në përshkrimin e detyrave, përgjegjësi si dhe kompleksitetin e punës, pozita e juaj është e barasvlershme me koeficientin tetë (8), si dhe informon ankuesen se DASHC është përgjegjës për politika të pagave gjegjësisht për vlerësim, aprovimin dhe klasifikimin e pozitave të punës në koeficientin përkatës të pagës, ndërsa institucioni punëdhënës është përgjegjës për sistemimin e nëpunësve në vendet përkatëse të punës.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore Kolegji i Këshillit ju referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 19 ku përcaktohet se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave*, ndërlidhur me këtë neni 3 i Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil ka përcaktuar se: *1. E drejta e nëpunësve civil për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara më këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil. 2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë....*, dhe rrjedhimisht Kolegji i Këshillit konstaton se e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësit civilë të cilët kryejnë detyra të ngjashme të punës dhe që kanë kualifikime dhe përvojën e kërkuar për pozitën përkatëse, duhet të realizojnë pagë të njëjtë për punë të njëjtë.

Kolegji për vendosje meritore të kësaj çështje juridike ka analizuar edhe dispozitat e Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, i zbatueshëm deri me datë 08.07.2020, përkatësisht dispozitat e Rregullores Nr.05/2012 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, dhe rrjedhimisht sipas nenit 29 të kësaj Rregullore është përcaktuara se: *1.Në pajtim me nenin 7, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit përkatës dërgon propozimin e klasifikimit të secilit vend të punës në gradat përkatëse të institucionit të tyre tek ministria përgjegjëse për administratë publike, në këtë kontekst me dispozitat e nenit 7 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë është paraparë se: 1.Udhëheqësit e institucioneve të administratës publike ia propozojnë gradat e pozitave në institucionin e tyre ministrisë përgjegjëse për administratë publike, në bazë të rekomandimeve të personit përgjegjës për burime njerëzore në institucionin e tyre, i cili është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe procedurave për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. 2. Grada për secilin pozicion të punës dhe ndryshimet, miratohen nga Qeveria, me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financat....*andaj, në kuptim të dispozitave ligjore si më lartë dhe meqenëse nga ministria përgjegjëse përkatësisht DASHC-ja përmes shkresës/emalit të datës 28.08.2020 ka konfirmuar që pozita e ankueses Zyrtare e Lartë për Destinim bazuar në përshkrimin e detyrave, përgjegjësi si dhe kompleksitetin e punës vlerësohet me koeficient tetë (8) të pagës, Kolegji vlerëson se organ i punësimit ka qenë i obliguar që të ndër marr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për harmonizimin e koeficientit të pagës së ankueses ashtu siç është përcaktuar në vet përmbajtjen e

malit të datës 28.08.2020 të DASHC-së, kështu që mbi këtë bazë rrjedhë së janë të bazuara pretendimet ankimore të ankues të ngritura në ankesës.

Andaj, nisur nga gjendja faktike dhe juridike e konstatuar si me lartë, Kolegji vlerëson së organi i punësimit gjegjësisht Agjencia e Statistikave të Kosovës duhet të veproj në pajtueshmëri të plot me dispozitat e nenit 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me të cilin është përcaktuar se: *Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë*, rrjedhimisht bazuar në konstatimin si me lart obligohet Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të inicioj veprimet e nevojshme ligjore për harmonizimin të koeficientit të pagës së nëpunës civilë Drita Sylejmani nga koeficienti shtatë (7) në tetë (8), si dhe të bëj kompensimin e diferencës së koeficient të pagës në mënyrë retroaktive duke filluar nga data 28.08.2020 respektivisht nga data e njoftimit të DASHC-së të datës 28.08.2020 deri në zbatimin e këtij vendimi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmer të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kolegji pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.520/2022

Çlirim Zeka


Procesmbajtës

Ardita Haxhukaj Demi


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë e Statistikave të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Statistikave të Kosovës
- Z. Fisnik Nuli, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe
- Arkioit të KPMSHCK-së

